



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Financave
Ministarstvo za Finansije - Ministry of Finance

**Raporti Gjashtëmuor (Janar - Qershor) 2018 - Zbatimi i Strategjisë për Reformën
e Menaxhimit të Financave Publike (SRMFP) të Kosovës 2016-2020.**

Prishtinë
2018

PËRMBAJTJA

Shkurtesat.....	3
Hyrje.....	4
Përmbledhje ekzekutive.....	4
1.1 Shtylla 1 Disiplina fiskale	7
Prioriteti 1: Saktësia e parashikimit të indikatorëve makroekonomik dhe të hyrave:	7
Prioriteti 2: Kontrolllet efektive të zotimeve.....	8
Prioriteti 3: Mbledhja e qëndrueshme e të hyrave	9
1.2 Shtylla 2: Efikasiteti alokues.....	11
Prioriteti 4: Zhvillimi i kornizës afatmesme të shpenzimeve (KASH)	11
Prioriteti 5: Besueshmëria dhe kontrolli i ekzekutimit të buxhetit vjetor.....	12
Prioriteti 6: Cilësia e informatave të buxhetit kapital	12
1.3 Shtylla 3: Efikasiteti operacional	13
Prioriteti 7: Prokurimi Publik	13
Prioriteti 8: Fuqizimi i auditimit të brendshëm.....	14
Prioriteti 9: Fuqizimi i auditimit të jashtëm.....	15
1.4 Shtylla 4: Çështjet e ndërlidhura të MFP.....	16
Prioriteti 10: Përmirësimi i sistemeve të TI.....	16
Prioriteti 11: Transparenca për buxhetin	16
Prioriteti 12: Ngritja e qëndrueshme e kapaciteteve në MFP	17
Aneks 1. SHPJEGIM I DETAJUAR MBI ZBATIMIN E SECILIT AKTIVITET	18

SHKURTESAT

AB - Auditimi i Brendshëm
ATK - Administrata Tatimore e Kosovës
BB - Banka Botërore
BDMS - (Budget Development and Management System) - Sistemi i Zhvillimit dhe Menaxhimit të Buxhetit
BE - Bashkimi Evropian
BQK - Banka Qendrore e Kosovës
DIEKP - Departamenti për Integrim Evropian dhe Koordinim të Politikave
FMN - Fondi Monetar Ndërkombëtare
GDPS - Grupi Drejtues për Planifikim Strategjik
IPSAS - (International Public Sector Accounting Standards) - Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik
ISSAI - (International Standards of Supreme Audit Institutions) Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit
KASH - Korniza Afatmesme e Shpenzimeve
KBFP - Kontrolli i Brendshëm i Financave Publike
KRPP - Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik
LMFPP - Ligji për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë
MF - Ministria e Financave
MFP - Menaxhimi i Financave Publike
NjQH - Njësia Qendrore Harmonizuese
OB - Organizatat Buxhetore
PIP - Programi i Investimeve Publike
SFQ (GFS)-FMNS - Statistikat Financiare Qeveritare
SIGMA - (Support for Improvement in Governance and Management) - Përkrahje për Përmirësim në Qeverisje dhe Menaxhment
SIMFK - Sistemi Informativ i Menaxhimit të Financave të Kosovës
SKZH - Strategjinë Kombëtare për Zhvillim
SRMFP - Strategjia për Reformën e MFP
TI - Teknologjia e Informacionit
TVSH - Tatimi në Vlerën e Shtuar
VNB - Vlerësimi i Ndikimit Buxhetor
ZKA - Zyra Kombëtare e Auditorit

HYRJE

Ky raport përmbledh dhe paraqet arritjet e prioriteteve dhe progresin në aktivitete të Strategjisë së Reformës së Menaxhimit të Financave Publike (SRMFP) gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2018. Hartimi i raportit monitorues gjashtëmujor ka për qëllim shqyrtimin e progresit të arritur në zbatimin e strategjisë si dhe identifikimin e sfidave. Për më shumë ky raport ka karakter informues me qëllim të identifikimit të problemeve në zbatim të strategjisë si dhe adresimin me kohë të tyre.

Sipas mandatit të dhënë me Vendimin e Ministrit, Nr. 43/2016, Grupi Koordinues për MFP obligohet të përgatisë raporte të rregullta vjetore dhe gjashtëmujore. Pas finalizimit të raportit vjetor për vitin 2017, ky është raporti i dytë gjashtëmujor i cili paraqet progresin e arritur në realizimin e aktiviteteve të planifikuara gjatë vitit 2018.

Qasja e adoptuar në përgatitjen e raportit gjashtëmujor ka qenë një kombinim i takimeve dhe konsultimeve në mes të DIEKP (MF) dhe bartësve kryesorë të secilit prioritet. Fillimisht është përgatitur tabela raportuese (e bazuar në udhëzimet e OECD/SIGMA) dhe mbi bazën e informacioneve të dhëna nga bartësit kryesorë është përpiluar Raporti narrativ gjashtëmujor.

Strategjia e Reformës së Menaxhimit të Financave Publike (SRMFP), është ndërtuar mbi 4 shtylla dhe 12 prioritete që përfshijnë të gjithat fushat e reformës së Menaxhimit të Financave Publike.

Në vijim raporti shpalosë zbatimin e aktiviteteve brenda secilit prioritet të definuar me Planin e veprimit të SRMFP-së. Po ashtu aty ku ka qenë e mundur raportimi është bërë edhe në nivel të indikatorëve. Duke pasur parasysh që një numër i indikatorëve vlerësohen në bazë vjetore raportimi mbi arritjen e tyre do të bëhet në raport vjetor

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Raporti i dytë gjashtëmujor i zbatimit të Strategjisë për Reformën e MFP evidenton progres të arritur në shumicën e aktiviteteve të parapara. Bazuar në raportet e pranuar nga strukturat përgjegjëse, nga gjashtëdhjetë e gjashtë (66) aktivitetet e planifikuara, me pesëdhjetë e një (51) pika të referimit, raportohet se:

- Në **pesëdhjetë (50) aktivitete** është shënuar progres në zbatim apo ka filluar zbatimi pa vonesa.
- Në **njëmbëdhjetë (11) aktivitete** nuk është raportuar progres apo janë evidentuar vonesa në fillim të zbatimit.
- Ndërsa **pesë (5) aktivitete** nuk janë zbatuar dhe planifikohen të zbatohen pas vitit 2018.

Përmbledhje e të arriturave

Në shtyllën e parë **Disiplina Fiskale**, në indikatorin e parë, dhe më të rëndësishëm, përmes aktiviteteve të ndërmarra, mund të raportojmë progres në arritjen e indikatorit për gjatë kësaj periudhe kohore. Shmangia mesatare e parashikimit të të hyrave tatimore në krahasim me gjendjen aktuale është -1.5%. Sipas të dhënave të Thesarit të bartura në sistemin e ATK-së, të hyrat e parashikuara ishin në vlerë 716.3 mil.€, ndërsa janë realizuar të hyra në vlerë prej 705.3 mil.€. Edhe gjatë pjesës së dytë të vitit 2018 pritet të jetë trend i njëjtë i realizimit të të hyrave.

Gjithashtu gjatë kësaj periudhë është arritur progres në zbatimin e aktiviteteve drejt realizimit të prioritetit të dytë Kontrollat efektive të zotimeve, gjegjësisht objektivit për Zvogëlimin e vonesave të pagesave duke e rritur pajtueshmërinë me kontrollet e aplikueshme të zotimeve. Me aktivitete të vazhdueshme është ngritur performanca e agjencive tatim-mbledhëse dhe është rritur qëndrueshmëria e mbledhjes së të hyrave përmes zgjerimit të bazës tatimore, masave kundër evazionit fiskal dhe kontrabandës. Edhe tek indikatorit i prioritetit të tretë Mbledhja e qëndrueshme e të hyrave, numri i bizneseve të regjistruara për TVSH ka tejkaluar numrin prej 22,000 ndërsa numri i tatimpaguesve që i deklarojnë të ardhurat në mënyrë vullnetare ka qenë 59,704 tatimpagues.

Gjatë vitit 2018 janë të planifikuara të zbatohen gjithsej 27 aktivitete (me 18 pika të referimit) të ndara në tri prioritete kryesore: Saktësia e parashikimit të indikatorëve makroekonomik dhe të hyrave, Kontrollat efektive të zotimeve dhe Mbledhja e Qëndrueshme e të hyrave. Bazuar në raportet e strukturave përgjegjëse, gjatë periudhës 6 mujore, nga 27 aktivitetet e planifikuara raportohet se në 20 prej tyre është shënuar progres në zbatim apo ka filluar zbatimin pa vonesa.

Në shtyllën e dytë **Efikasiteti Alokues**, progresi është arritur në fuqizimin e besueshmërisë së buxhetit vjetor përmes përmirësimit të planifikimit buxhetor dhe besueshmërisë së tij duke siguruar që hartimi i buxhetit është në përputhje me kornizën makro-fiskale si dhe prioritetet strategjike të Qeverisë. Në këtë drejtim është shqyrtuar Deklarata e Prioriteteve dhe KASH (2019-2021) nga Grupi Drejtues për Planifikim Strategjik. Në të dy rastet raportimi për indikator bëhet në nivel vjetor.

Në këtë shtyllë janë të planifikuara të zbatohen **12 aktivitete** të ndara në tri prioritete kryesore: Zhvillimi i Kornizës Afatmesme të shpenzimeve, Besueshmëria dhe kontrolli i ekzekutimit të buxhetit vjetor dhe Cilësia e informatave të buxhetit kapital. Bazuar në raportet e strukturave përgjegjëse raportohet se në tetë (8) prej tyre është shënuar progres në zbatim apo ka filluar zbatimin pa vonesa.

Në shtyllën e tretë të strategjisë **Efikasiteti funksional**, raportohet se aktivitetet që kanë të bëjnë me fushën e prokurimit, janë duke u realizuar konform planit. KRPP gjatë kësaj periudhe ka arritur avancimin e sistemit të monitorimit të zbatimit dhe atë jo vetëm në monitorimin e pajtueshmërisë por edhe të efikasitetit gjatë zbatimit të procedurave të prokurimit publik. Po ashtu është shënuar progres i kënaqshëm në zbatimin e aktiviteteve në fushën e auditimit të brendshëm, ku si rezultat është raportuar për përmirësim të përqindjes së auditorëve të brendshëm të certifikuar (85% Qershor 2018, krahasuar me vlerën bazë prej 50%). Gjithashtu është arritur progres në fuqizimin e auditimit të jashtëm. Gjatë kësaj periudhe është raportuar për azhurnim të rregullt të udhëzuesit dhe metodologjisë së ZKAsë për auditimin e rregullsisë dhe performancës në përputhje me standardet ndërkombëtare të auditimit. Kanë vazhduar bashkëpunimet me dy komisionet parlamentare: Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike dhe Komisioni për Buxhet për të diskutuar në lidhje me përmbledhjet e raporteve të auditimit të ZKA për Komisionet parlamentare, më konkretisht përgatitja e materialeve për trajtimet e Raporteve të auditimit.

Në këtë shtyllë janë të planifikuara të zbatohen **15 aktivitete** të ndara në tri prioritete kryesore: Prokurimi Publik, Fuqizimi i Auditimit të Brendshëm dhe Fuqizimi i Auditimit të Jashtëm. Bazuar në raportet e strukturave përgjegjëse, raportohet se në katërmëdhjetë (14) aktivitete është shënuar progres në zbatim apo ka filluar zbatimin pa vonesa. Nuk është ndërmarrë asnjë aktivitet lidhur me trajnimin e Auditorëve të Brendshëm në auditimin e fondeve të BE-së.

Në shtyllën e katërt të strategjisë **Çështjet e ndërlidhura me MFP**, Thesari gjatë kësaj periudhe gjashtë mujore ka zhvilluar aktivitete të shumta në funksion të përmirësimit të sistemit të teknologjisë informative dhe proceseve që ndërlidhen me procesin buxhetor. Ka përfunduar

analiza e nevojave për integrim të sistemeve si dhe dizajnimi i zgjidhjes. Ka filluar pilotimi tek disa OB për krijimin e arkivës elektronike duke bashkëngjitur dokumentacionin financiar si Kontrata dhe Fatura në SIMFK. Brenda kësaj periudhe, për sa i përket transparencës për buxhetin, Thesari në bashkëpunim me projektin e USAID, kanë draftuar Planin kontabël ekzistues sipas GFSM 2014. Në të njëjtën kohë, Thesari ka vazhduar me publikimin e rregullt të të dhënave mujore/serive kohore për të hyrat dhe shpenzimet buxhetore për periudhën 2006-2018. Në ueb-faqen e MF është mundësuar publikimi dhe qasja në të dhëna fiskale në baza mujore, në format elektronik, duke ofruar transparencë të plotë për shfrytëzimin e parasë publike. Për më shumë, Informatori për qytetarët për Buxhetin e Kosovës për vitin 2018 është i publikuar në ueb faqen e MF (<http://mf.rks-gov.net/page.aspx?id=1,33>).

Në këtë shtyllë janë planifikuar të zbatohen gjithsej **12 aktivitete** të ndara në tri prioritete të ndryshme: Përmirësimi i Sistemeve të TI-së, Transparenca për Buxhetin dhe Ngritja e Qëndrueshmërisë së Kapaciteteve në MFP. Bazuar në raportet e strukturave përgjegjëse, gjatë periudhës 6 mujore, nga 12 aktivitetet e planifikuara raportohet së në tetë (8) prej tyre është shënuar progres në zbatim apo ka filluar zbatimin pa vonesa.

Përmbledhje e sfidave

Raporti konstaton se shumica e aktiviteteve të identifikuara me ngecje apo vonesë në zbatim janë jo relevante për prioritetin përkatës. Këtë e vërteton progresi i evidentuar në zbatimin e Prioritetit, e në disa raste edhe realizimi i Indikatorëve (ku ka qenë e mundur sigurimi i vlerave të indikatorëve). Gjithashtu disa nga aktivitetet për shkak të mungesës së mjeteve financiare janë shtyrë për zbatim në vitin e ardhshëm. Që të dy kategoritë e këtyre aktiviteteve do të jenë pjesë e rishikimit të Planit të Veprimit 2019-2020 të SRMFP-së.

Në shtyllën e parë **Disiplina Fiskale**, nga gjithsej njëzet e shtatë (27) aktivitete, në shtatë (7) prej tyre nuk është raportuar progres apo janë evidentuar vonesa në fillim të zbatimit.

Në shtyllën e dytë **Efikasiteti Alokues**, nga gjithsej dymbëdhjetë (12) aktivitete, për dy (2) nuk është raportuar progres apo janë evidentuar vonesa në fillim të zbatimit, ndërsa dy (2) aktivitete tjera që ndërlidhen me buxhetimin bazuar në programe, nuk janë zbatuar dhe planifikohen të zbatohen pas vitit 2018.

Në shtyllën e tretë të strategjisë **Efikasiteti funksional**, është raportuar për ngecje në indikatorin e dytë që ka të bëjë me përqindjen e zbatimit të rekomandimeve të zbatuara nga menaxhmenti. Në mos përmbushjen e plotë të indikatorit të dytë kanë ndikuar organizimi i zgjedhjeve lokale dhe vonesat në konstituimin e organeve komunale. Nga gjithsej 15 aktivitete, është raportuar për vonesa në zbatimin e një (1) aktiviteti, Trajnimi i auditorëve të brendshëm në auditimin e fondeve të BE, për shkak të mungesës së përkrahjes buxhetore.

Në shtyllën e katërt të strategjisë **Çështjet e ndërlidhura me MFP**, në fushën e fuqizimit të kapaciteteve në fushën e MFP, përkundër masave të ndërmarra, është raportuar për vonesa në zbatim të aktiviteteve që kryesisht ndërlidhen me mungesën e sigurimit të fondeve. Mos zhvillimi i studimit të fizibilitetit mbi Qendrën e Trajnimeve për MFP, përfshirë vlerësimin e nevojave për trajnime ka ndikuar në mënyrë zinxhirore në mos zbatimin e dy aktiviteteve vijuese. Nga gjithsej **12 aktivitete** të ndara në tri prioritete të ndryshme, katër (4) nuk janë zbatuar dhe planifikohen të zbatohen pas vitit 2018.

1.1 SHTYLLA 1 DISIPLINA FISKALE


PRIORITETI 1: SAKTËSIA E PARASHIKIMIT TË INDIKATORËVE MAKROEKONOMIK DHE TË HYRAVE:

Prioriteti i parë i SRMFP, i referohet avancimit të saktësisë së parashikimit të indikatorëve makroekonomik, përfshirë parashikimin e të hyrave, si bazë e përcaktimit të hapësirës fiskale për financim të politikave publike të Qeverisë. Institucioni përgjegjës për arritje të këtij prioriteti është Ministria e Financave – Departamenti për Politika Ekonomike dhe bashkëpunim ndërkombëtar financiar / Makroekonomisë. Arritja e këtij prioriteti përmirëson cilësinë e informatave të nevojshme për vendim-marrësit politik si dhe do të krijojë një bazë të shëndoshë për bashkëpunim efektiv me partnerët financiar ndërkombëtar, duke i kontribuar ruajtjes së stabilitetit makroekonomik si një prej synimeve afat-gjatë të menaxhimit të financave publike.

Për gjashtëmujorin e parë të vitit 2018, mund të raportojmë se trendi i realizimit të hyrave tatimore është në harmoni me parashikimet buxhetore. Në kuadër të këtij prioriteti, janë planifikuar pesë (5) aktivitete. Megjithatë ajo çfarë mund të thuhet është se gjatë këtij gjashtëmujori (Janar – Qershor 2018), nga pesë aktivitete të planifikuara për arritjen e këtij prioriteti, një veprim është zbatuar, një nuk është relevant pasi që ligji për Faljen e Borxheve nuk është më në fuqi, ndërsa tre prej tyre (1.2- 1.4) mbetet të përshpejtohen aktivitetet gjatë periudhës së ardhshme¹. Rishikimi i Strategjisë do ketë parasysh të gjeturat e këtij raporti në mënyrë që të identifikohen aktivitete sa më relevante me qëllim të arritjes së treguesve.

Në treguesin e parë, dhe më të rëndësishëm, përmes aktiviteteve të ndërmarrja, mund të raportojmë progres në arritjen e treguesit për gjatë kësaj periudhe kohore. Gjatë periudhës Janar-Qershor 2018, shmangia mesatare e parashikimit të të hyrave tatimore në krahasim me gjendjen aktuale është -1.5%. Ishin parashikuar të hyra në vlerë 716.3mil.€, ndërsa janë realizuar të hyra në vlerë prej 705.3 mil.€. Edhe gjatë pjesës së dytë të vitit 2018 pritet të jetë trend i njëjtë i realizimit të të hyrave.

Në pjesën e të hyrave të njehershme, sipas raportit gjashtëmujor të departamentit të Thesarit, gjatë periudhës Janar-Qershor 2018 janë planifikuar të hyra të njehershme në vlerë prej 4 milion €, mirëpo nuk janë deklaruar të hyra në këtë kategori.

 Prioriteti 1. Një parashikim i kujdesshëm dhe real i të hyrave tatimore të buxhetit dhe të hyrave të njehershme				
Treguesi (-ët) për matjen e arritjes së Prioritetit	Baza	Qëllimi 2018	Qëllimi 2020	Raportimi Janar- Qershor 2018
Shmangia mesatare e parashikimit të të hyrave tatimore në krahasim me ekzistueset.	(-7.7%)	5%	0 - 3 %	-1,5 % ²
Shmangia mesatare e parashikimit të të hyrave që ndodhin në buxhet vetëm një herë në krahasim me ekzistueset.	7.6%	5%	4%	Raportimi ne baze vjetore

¹ Shpjegimet detaje për progresin në secilin aktivitet janë dhënë në Aneksin 1

² Burimi i të dhënave MF/Thesari dhe sistemi i ATK-së.

PRIORITETI 2: KONTROLLET EFEKTIVE TË ZOTIMEVE


Aftësia për të shlyer në kohë (1-30 ditë) pagesat e arritura është prioriteti 2 i reformës në shtyllën e parë. Qëllimi i këtij prioriteti janë kontrollet efektive të zotimeve, ku synohet të arrihet duke menaxhuar më mirë vonesat e pagesave përmes kontrolleve financiare në zotime. Institucionet kryesore përgjegjëse për arritje të këtij prioriteti janë Thesari dhe Njësia Qendrore Harmonizuese.

Gjatë gjashtëmuajorit të parë të vitit 2018, është raportuar të jetë shënuar progres i pjesshëm në zbatimin e aktiviteteve drejt realizimit të prioritetit Nr.2. gjegjësisht Prioritetit për Zvogëlimin e vonesave të pagesave duke e rritur pajtueshmërinë me kontrollet e aplikueshme të zotimeve. Brenda kësaj periudhe është raportuar të jetë miratuar dhe dekretuar nga Presidenti i vendit, Ligji mbi Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike (KBFP). Zbatimi i këtij ligji pritet të avancoj sistemin e kontrollit të brendshëm të financave publike, që përfshin menaxhimin financiar dhe kontrollin, auditimin e brendshëm, si dhe harmonizimin e tyre, në pajtim me standardet ndërkombëtare për kontrollin e brendshëm dhe auditimin e brendshëm. Përmes zbatimit të ligjit dhe akteve tjera sekondare legjislative, pritet të vendoset një linjë më e qartë e përgjegjësisë dhe llogaridhënies brenda OB-ve, që do të ofrojnë kontroll efektiv mbi resurset publike dhe politikat zbatuese publike. Në mes tjerash, me zbatimin e këtij ligji, Kryesuesi i Organizatës Buxhetore (OB) ka përgjegjësinë e nënshkrimit të dyfishtë, rishikimin e pajtueshmërisë para ndodhjes, prezantimi i deklaratës së kontrollit të brendshëm i nënshkruar nga Kryesuesi i OB, ZKA dhe ZKF i OB si pjesë e raportimit financiar; zbatimi i sanksioneve për ata që janë përgjegjës për gabimet në raportim dhe mos-veprimi në pajtueshmëri me rregulloret për shpenzimin e resurseve buxhetore. Prezantimi i kërkesës për kualifikimet profesionale të ZKF. Si rezultat, NQH ka filluar procedurat për nxjerrjen e udhëzimeve administrative. Është formuar komisioni për hartimin e udhëzimit administrativ për përcaktimin e kriterëve për themelimin e njësive të auditimit të brendshëm dhe komiteteve të auditimit si dhe komisioni për plotësim ndryshimin e rregullores 01/2010 për menaxhim financiar dhe kontroll për harmonizim me Ligjin e Kontrollit të Brendshëm të Financave Publike.

Ky prioritet, po ashtu bazohet edhe në disa aktivitete që mbulojnë forcimin e funksionit të auditimit të brendshëm të matura me Certifikimin e Auditorëve të Brendshëm, zhvillimin e mëtejshëm të stafit të NJQH dhe veprimet që kanë të bëjnë me librin e proceseve. Në këtë drejtim, gjatë periudhës Janar- Qershor 2018, është raportuar për organizim të trajnimeve në përgatitjen e "Planit të veprimit për implementimin e rekomandimeve të Auditorit të përgjithshëm dhe të brendshëm " ku kanë marr pjesë 70 pjesëmarrës nga OB të ndryshme. Po ashtu gjatë kësaj periudhe po zhvillohet një trajnim për ngritjen e transparencës nëpër komuna pilote. Po ashtu me qëllim të identifikimit dhe krijimit të kontrolleve, në bashkëpunim me USAID është organizuar punëtorja për përshkrimin e proceseve. Ky dokument përfshinë përgatitjen e procedurave standarde të operimit, përfshirë përshkrimet e proceseve dhe diagrameve me kontrollet e identifikuar, siç është planifikimi i buxhetit, zbatimi i buxhetit, përvetësimet, zotimet, prokurimi publik, menaxhimi i të hyrave dhe i shpenzimeve, pagesa e aseteve dhe përgjegjësia e menaxhimit . Dokumenti i aprovuar nga MF, iu është dorëzuar OB-ve.

Tek gjithsej dhjetë (10) aktivitete të planifikuara për zbatim të këtij prioriteti, në krahasim me pikat referuese për vitin 2018 është evidentuar progres në zbatim tek një numër i konsiderueshëm i aktiviteteve edhe pse janë aktivitete në proces përgjatë tërë vitit siç janë

aktivitetet : 2.1; 2.2; 2.4; 2.6; 2.7; 2.8; 2.9 dhe 2.10. Ndërsa në dy prej aktivitetëve është raportuar për vonesa në zbatim 2. 3 dhe 2.5³.

 Prioriteti 2. Zvogëlimi i vonesave të pagesave duke e rritur pajtueshmërinë me kontrollet e aplikueshme të zotimeve.				
Treguesi (-ët) për matjen e arritjes së Prioritetit	Baza	Qëllimi 2018	Qëllimi 2020	Raportimi Janar- Qershor 2018
1. Borxhet e pakryera të pagesave deri në fund të vitit fiskal si % e totalit të shpenzimeve.	3.4%	2%	1%	Raportimi ne fund te vitit fiskal

PRIORITETI 3: MBLEDHJA E QËNDRUESHME E TË HYRAVE

Sistemi aktual i menaxhimit të financave publike në Kosovë e mbështet disiplinën e përgjithshme fiskale. Për ta mbajtur qëndrueshmërinë në disiplinën fiskale është e nevojshme gjetja e zëvendësimeve të brendshme për të hyrat nga kufiri, e cila do të ndikojë në financimin e investimeve publike të nevojshme për rritje të qëndrueshme ekonomike dhe për t'i adresuar sfidat e shumta.

Janë gjithsej 12 aktivitete të planifikuara për realizimin e Prioritetit 3, Mbledhja e Qëndrueshme e Të hyrave, me përgjegjësi të ndara në mes të ATK-së dhe Doganave të Kosovës. Nga të gjitha aktivitetet e planifikuara në njërin prej aktivitetëve 3.4 është raportuar për vonesa në zbatim, ndërsa në aktivitetet tjera është shënuar progres i kënaqshëm⁴.

Gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2018, me aktivitete të vazhdueshme është ngritur performanca e agjencive tatim-mbledhëse dhe është rritur qëndrueshmëria e mbledhjes së të hyrave përmes zgjerimit të bazës tatimore, masave kundër evazionit fiskal dhe kontrabandës. Numri i bizneseve të regjistruara për TVSH ka tejkaluar numrin prej 22,000 bizneseve.

Gjatë periudhës raportuese, ATK ka realizuar aktivitete operative me qëllim të identifikimit të bizneseve të cilat janë afër pragut për të qenë subjekt i TVSh. Përveç kësaj, janë realizuar edhe vizita edukative të cilat kanë pasur në fokus informimin e bizneseve të cilat janë regjistruar rishtas në TVSh. Gjatë periudhës Janar – Qershor 2018, janë regjistruar gjithsej 2,036 biznese të reja që janë subjekt i TVSh. Sikurse në raportin e vitit 2017, ATK është duke vazhduar me zbatimin e Udhëzuesit për trajtimin e mos deklaruesve. Faza e fundit, e këtij procesi është tërheqja e certifikatës së TVSh dhe publikimi në ueb faqe, që nënkupton që këta tatimpagues nuk mund të zhvillojnë aktivitete biznesore me biznese tjera. Zvogëlimi i numrit të mos deklaruesve, ndikon në ruajtjen e regjistrit të tatimpaguesve të regjistruar në TVSh, e që është një element i pandashëm nga regjistrimi i bizneseve të reja në TVSh. Gjithashtu lidhur me trajtimin e mos-deklaruesve, ATK është në proces të themelimit të njësisë së veçantë e cila do të merret me identifikimin e mos deklaruesve dhe veprimin sipas udhëzimit.


³ Shpjegimet detaje për progresin në secilin aktivitet janë dhënë në Aneksin 1

⁴ Shpjegimet detaje për progresin në secilin aktivitet janë dhënë në Aneksin 1

Gjatë periudhës raportuese, numri i tatimpaguesve që i deklarojnë të ardhurat në mënyrë vullnetare ka qenë 59,704 tatimpagues. Ky indikator gjithashtu ndërlidhet me zhvillimet që kanë ndodh në trajtimin e mos deklaruesve e që janë paraqitur më lartë.

Gjatë periudhës raportuese, shkalla e mbledhjes së borxheve ka qenë 14%. Përqindja e borxhit të mbledhur (borxhi tatimor) në një pjesë të shumës totale të borxhit të arkëtueshëm llogaritet duke përdorur formulën, e cila përfshin borxhet e mbledhura brenda vitit fiskal siç përcaktohet në "Ligjin për Administratën Tatimore dhe Procedurat". Në mënyrë të veçantë, borxhet që janë më pak se gjashtë (6) vjeç dhe nuk përputhen me kushtet e paragrafit 1 të nenit 43 të Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat konsiderohen si borxhe të arkëtueshme pas vlerësimit të taksave / zgjidhjes së mosmarrëveshjeve, janë pjesë e borxhit të mbledhshëm. Ndërsa shkalla e borxheve të trajtuara ishte 30.33%. Deri më 30 Qershor 2018 stoku i borxhit aktiv ishte 275,027,046.43 euro dhe inkasimi ishte 38,139,774.22 euro. Lidhur me zbatimin e këtij treguesi, është zhvilluar Plani Operativ vjetor, i cili përmban aktivitetet dhe afatet e trajtimit të borxhit tatimor. Në këtë plan, janë të përfshira borxhet të cilat ATK ka kompetencë ligjore në mbledhjen e tyre, pra borxhet e mbledhshme. Ky aktivitet monitorohet nga zyra qendrore e ATK në baza ditore, me qëllim të përcjelljes së trendit. Gjithashtu, në planin e fundit të Modernizimit të ATK, i cili konsiderohet si plani me reformë më të thellë në ATK, ky proces është i përfshirë.

Gjithashtu, është raportuar për progres të kënaqshëm edhe në aktivitetet që janë pjesë e kompetencave të Doganës të Kosovës, e që ndërlidhen më zhvillimin e kapacitetit të zyrtareve doganorë në fushat e origjinës dhe vlerësimit të mallit. Modernizimi i mëtutjeshëm i Administratës Doganore, është në proces duke u fokusuar në disa fusha të rëndësishme, përfshirë menaxhimin e riskut dhe fuqizimin e masave kundër kontrabandës duke bashkëpunuar ngushtë me Policinë e Kosovës.

 Prioriteti 3. Zgjerimi i bazës tatimore përmes luftimit të evazionit fiskal dhe kontrabandimit të mallrave.				
Treguesi (-ët) për matjen e arritjes së Prioritetit	Baza	Qëllimi 2018	Qëllim i 2020	Raportimi Janar- Qershor 2018
1.Numri i bizneseve të regjistruara për TVSH	16,583	21,750	35,000	22,334
2. Numri i tatimpaguesve që i deklarojnë të ardhurat në mënyrë vullnetare.	62,886	73,117	100,000	59,704
3. Shkalla e mbledhjes së borxheve.	16%	18%	19%	14% ⁵

⁵ Të dhënat janë vetëm për 6 muaj. Qëllimi pritet të arrihet deri në Dhjetor 2018.

1.2 SHTYLLA 2: EFIKASITETI ALOKUES

PRIORITETI 4: ZHVILLIMI I KORNIZËS AFATMESME TË SHPENZIMEVE (KASH)

Ndërlidhja në mes të strategjive kombëtare dhe planifikimit buxhetor afatmesëm dhe vjetor është arritja më sfiduese edhe në terma të politikë bërjes por edhe të kapaciteteve teknike. Ndër vite është vërejtur një trend zhvillimi pozitiv në proceset dhe përmbajtjen e Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve (KASH). Planifikimi afat mesëm fiskal, bëhet mbi bazën e dokumenteve strategjike, duke marrë për bazë deklaratën e prioriteteve të Qeverisë, kapacitetet qeveritare që janë në dispozicion, burimet e financimit dhe natyrën dinamike të këtyre dokumenteve të politikave.

Qasja sektoriale, komunikimi dhe këshillimi i profesionalizuar nga MF ka ndikuar në fuqizimin e integritetit të KASH-it si dokument bazë për përpilimin e buxhetit vjetor dhe vlerësimin për dy vitet e ardhshme.

Janë gjithsej pesë (5) aktivitete të planifikuara në planin e veprimit të SRMFP-së, me qëllim të avancimit të mëtejshëm të rolit të KASH-it si dokument ndërlidhës ndërmjet Strategjisë Kombëtare dhe planifikimit të buxhetit për tre vitet ardhshme. Në krahasim me pikat referuese për vitin 2018 është evidentuar progres në zbatimin e katër aktiviteteve 4.1; 4.2; 4.4 dhe 4.5, ndërsa që aktiviteti 4.3 është në proces dhe finalizimi i tij është i ndërlidhur me K4 të vitit 2018⁶

Departamenti i Buxhetit, ka hartuar me kohë Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve 2019-2021. Treguesi do të raportohet në raportin vjetor 2018. Departamenti i Buxhetit, ka vazhduar me ofrimin e trajnimeve të zyrtarëve në fushën e vlerësimin të ndikimit buxhetor si dhe ka finalizuar hartimin e Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve 2019-2021 sipas qasjes sektoriale. Sa i përket treguesit të dytë në këtë periudhë raportuese, numri i zyrtarëve të këshilluar për vlerësimin e ndikimit buxhetor (VNB), trajnime dhe këshillime të personalizuara, ka qenë rreth 50 zyrtarë.

Treguesi (-ët) për matjen e arritjes së Prioritetit	Baza	Qëllimi 2018	Qëllim i 2020	Raportimi Janar- Qershor 2018
Përqindja e shmangies mesatare ndërmjet kufirit të KASH dhe kufirit vjetor buxhetor për OB-të.	7.15 %	6.5 %	3.5%	NA
Numri i zyrtarëve të trajnuar për vlerësimin e ndikimit buxhetor-VNB.	80	90	120	50

⁶ Shpjegimet detaje për progresin në secilin aktivitet janë dhënë në Aneksin 1

PRIORITETI 5: BESUESHMËRIA DHE KONTROLLI I EKZEKUTIMIT TË BUXHETIT VJETOR

Fuqizimi i besueshmërisë së buxhetit vjetor përmes përmirësimit të planifikimit buxhetor përfshirë planifikimin në nivel të programeve dhe përputhjes me kornizën makro-fiskale si dhe Prioritetet strategjike të Qeverisë është një ndër prioritetet e SRMFP-së. Në kuadër të këtij prioriteti janë planifikuar 3 aktivitete. Në përgjithësi është raportuar për vonesë në zbatim të këtyre aktiviteteve për shkak të kompleksitetit të këtij procesi.

Sa i përket shmangies mesatare (%) te ekzekutimit të përgjithshëm të buxhetit krahasuar me buxhetin e aprovuar në fillim të vitit sipas OB-ve të nivelit qendror, në këtë periudhë të raportimit nuk mund të llogaritet, pasi që për matjen e këtij treguesi duhet të merret për bazë buxheti i aprovuar në fillim të vitit dhe buxheti në fund të vitit sepse procesi i realizimit të buxhetit bëhet deri me 31 dhjetor 2018 me mbylljen e vitin fiskal 2017. Po ashtu edhe për treguesin e dytë nuk mund të llogaritet në këtë periudhë gjashtë mujore, pasi që për llogaritjen e këtij treguesi duhet të merret për bazë numri i transfereve të përgjithshme gjatë tërë vitit fiskal për vitin 2018.

Treguesi (-ët) për matjen e arritjes së Prioritetit	Baza	Qëllimi 2018	Qëllim i 2020	Raportimi Janar- Qershor 2018
Përqindja e shmangies mesatare të ekzekutimit të përgjithshëm të buxhetit krahasuar me buxhetin e aprovuar në fillim të vitit sipas OB të nivelit qendror.	10.46%	9.0%	5%	NA
Nr. i transfereve gjatë vitit fiskal	199	170	100	NA

PRIORITETI 6: CILËSIA E INFORMATAVE TË BUXHETIT KAPITAL

Ndërlidhja sistematike e projekteve kapitale me Strategjinë Kombëtare për Zhvillim (SKZH) dhe me politikat sektoriale, cilësinë e analizës teknike të projekteve është një nga Prioritetet e SRMFP. Është vazhduar me rritjen e efikasitetit dhe efektivitetit të menaxhimit të planifikimit dhe monitorimit të investimeve publike nga OB-të në sistemin e PIP (Programi i Investimeve Publike). Për arritjen e këtij prioriteti planifikohen gjithsej 4 aktivitete. Në këtë fazë nuk mund të bëhet raportimi në bazë të treguesit për shkak që treguesi do të kalkulohet në bazë vjetore. Gjatë kësaj periudhe Janar- Qershor 2018, janë ndërmarrë disa hapa drejt përmirësimit të rregullativës ligjore, mirëpo ende mbetet të punohet në këtë drejtim. Më specifikisht gjatë kësaj periudhe është themeluar GP brenda MF për hartim të rregullores në bazë të së cilës do të përcaktohet metodologjia e vlerësimit dhe përzgjedhjes së projekteve. Ngjashëm me këtë është themeluar po ashtu grupi tjetër punues për hartim të një udhëzimi që e definon qartë se çka duhet të trajtohet projekt kapital. Të dy këto aktivitete priten të realizohen deri në fund të vitit 2018 dhe në të dyja ka pasur vonesa në zbatim të tyre krahasuar me pikën e referimit për 2018.



Prioriteti 6. Një menaxhim më efikas dhe më efektiv i planifikimit dhe monitorimit të investimeve publike nga OB-të në sistemin e PIP-it do të ndikoj në një planifikim të drejt të projekteve kapitale që duhet të jenë të ndërlidhura me Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe me prioritetet e Qeverisë

Treguesi (-ët) për matjen e arritjes së Prioritetit	Baza*	Qëllimi 2018	Qëllim i 2020	Raportimi Janar- Qershor 2018
1. Numri i ri-alokimeve për OB të nivelit qendror.	65	55	25	NA
2. Përqindja e zbatimit të buxhetit të investimeve kapitale krahasuar me buxhetin e planifikuar brenda një viti fiskal	98%	99 %	100 %	NA

1.3 SHTYLLA 3: EFIKASITETI OPERACIONAL

PRIORITETI 7: PROKURIMI PUBLIK

Në këtë Prioritet të reformës së SRMFP, veprimet e ndërmarra kanë rezultuar me ngritje të garancive për sigurimin e përdorimit efikas dhe transparent të fondeve publike. Në gjashtëmujorin e parë të vitit 2018, raportohet se shumica e veprimeve janë duke u realizuar konform parashikimeve të cilat janë vendosur për këtë vit.

Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik (KRPP) përmes këtyre veprimeve ka arritur avancimin e sistemit të monitorimit të zbatimit dhe atë jo vetëm në monitorimin e pajtueshmërisë por edhe të efikasitetit gjatë zbatimit të procedurave të prokurimit publik. Megjithatë, ende nuk është filluar me monitorim të menaxhimit të kontratave për shkak të mos funksionalizimit të këtij moduli brenda platformës elektronike.

Aplikimi i sistemit elektronik nga të gjitha autoritetet kontraktuese nga 1 janari i vitit 2017, është një element shtytës për rritjen e efikasitetit dhe efektivitetit gjatë zbatimit të ligjit të prokurimit. Prokurimi elektronik do të ketë efekte shumë dimensional si në rritjen e transparencës, parandalimin e keqpërdorimeve, rritjen e konkurrencës dhe shtimin e përgjegjësisë dhe besimit gjatë zbatimit të procedurave të prokurimit. Prokurimi elektronik përveç tjerash në të ardhmen do të ndihmojë edhe në lehtësimin e monitorimit pasi të dhënat për performancën e autoriteteve kontraktuese mund të nxirren nga sistemi.

Gjithashtu progres është shënuar në ngritjen e kapaciteteve teknike për përdorimin e sistemit të e-prokurimit për Autoritetet Kontraktuese, për të ekzekutuar dhe menaxhuar në mënyrë më efikase procedurat e prokurimit. Gjatë kësaj periudhe, janë trajnuar rreth 780 persona, që përfshinë; zyrtaret në nivel qendror, lokal dhe ndërmarrjet publike, përfshirë Operatorët Ekonomik, auditorët e brendshëm të institucioneve publike lokale dhe qendrore, drejtorët e drejtorive komunale Anëtarët e Komisionit për hapjen e ofertave dhe vlerësim të tenderëve. Tutje, progres është shënuar edhe në zbatimin e aktiviteteve të prokurimit të centralizuar,



Prioriteti 7. Sigurimi i përdorimit efikas, transparent dhe të drejtë të fondeve publike si dhe realizimi i parimit kryesor në prokurimin publik “vlera për para”.

Treguesi (-ët) për matjen e arritjes së Prioritetit	Baza	Qëllimi 2018	Qëllim i 2020	Raportimi Janar- Qershor 2018
Përqindja e përdorimit të Procedurës së Negociuar pa publikim.	12,98 % ⁷	10%	7%	NA
Përqindja e monitorimit të njoftimeve për kontratë.	5%	100 %	100%	NA

PRIORITETI 8: FUQIZIMI I AUDITIMIT TË BRENDSHËM


Fuqizimi i auditimit të brendshëm është me rëndësi sepse ndihmon menaxhmentin në arritjen e objektivave të organizatës duke dhënë këshilla të pavarura për fuqizimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm të financave publike, vlerësuar lidhjet e këtyre sistemeve në arritjen e objektivave, bërë vlerësimin e rreziqeve që shoqërohen me sistemet në arritjen e qëllimeve të qeverisë dhe ndihmon në ngritjen e standardeve të qeverisjes.

Në këtë kontekst me qëllim të arritjes së prioritetit për Fuqizim të funksionit të auditimit të brendshëm si shërbim me vlerë të shtuar ndaj menaxhimit llogaridhënës, janë planifikuar gjithsej katër (4) aktivitete. Në këtë drejtim, MF ka vepruar në përmirësimin e infrastrukturës ligjore, nënligjore dhe në ngritjen e kapaciteteve njerëzore për një funksion më të mirë të auditimit të brendshëm të matur me cilësinë e rekomandimeve të auditimit dhe zbatimin e tyre nga menaxhmenti.

Pas miratimit të Ligjit mbi Auditimin e Brendshëm, në bashkëpunim me USAID, NJQH ka organizuar punëtori për përgatitjen e planit të veprimit për implementimin e rekomandimeve të Auditorit të Përgjithshëm dhe të brendshëm, kanë marrë pjesë 70 pjesëmarrës. Gjithashtu, NJQH, ka vazhduar me organizimin e trajnimeve teorike dhe praktike, brenda programit të licensuar për certifikim të auditorëve të brendshëm. Si rezultat, brenda kësaj periudhe janë certifikuar 70 pjesëmarrës.

Aktivitetet e ndërmarra nga Ministria e Financave në prioritetin 8, kanë ndikuar në rritjen e përqindjes së numrit të auditorëve të brendshëm të certifikuar, ndërsa që është raportuar për ngecje në treguesin që ka të bëjë me përqindjen e zbatimit të rekomandimeve të zbatuara nga menaxhmenti. Në mos përmbushjen e plotë të treguesit të dytë, për gjatë vitit 2017, kanë ndikuar organizimi i zgjedhjeve lokale dhe vonesat në konstituimin e organeve komunale.

⁷Vlera bazë i referohet vitit 2014. Për vitin 2015 vlera është 16.1%

	Prioriteti 8. Fuqizimi i funksionit të auditimit të brendshëm si shërbim me vlerë të shtuar ndaj menaxhimit llogaridhënës			
Treguesi (-ët) për matjen e arritjes së Prioritetit	Baza	Qëllimi 2018	Qëllimi 2020	Raportimi Janar- Qershor 2018
1. Përqindja (%) e auditorëve të brendshëm të certifikuar.	50% e AB të certifikuar	80% e AB të certifikuar	90% e AB të Çertifikuar	NA
2. Përqindja (%) e implementimit të rekomandimeve nga menaxhmenti	51% e implementimit të rekomandimeve nga menaxhmenti	Implementimi 55% i rekomandimeve nga menaxhmenti	Implementimi 65% e rekomandimeve nga menaxhmenti	NA

PRIORITETI 9: FUQIZIMI I AUDITIMIT TË JASHTËM

Prioriteti nëntë i shtyllës së tretë merret me auditimin e jashtëm dhe rezultati kryesor është zhvillimi i një institucioni suprem të auditimit që funksionon mirë, i cili kryen auditime në përputhje me standardet e auditimit të sektorit publik. Gjatë kësaj periudhe gjashtë mujore është raportuar progres në zbatimin e gjithsej pesë (5) aktiviteteve të planifikuara për arritjen e këtij prioriteti. Pas miratimit të Ligjit të ri, i cili ka përcaktuar qartë pavarësinë e institucionit, Auditori i Përgjithshëm ka vazhduar me hartimin e legjislacionit sekondar. ZKA, gjatë kësaj periudhe ka raportuar se ka hartuar draftin e “Planit Strategjik të Zyrës Kombëtare të Auditimit 2018-2021”, ku një prej qëllimeve kryesore strategjike do të jetë zhvillimi i mëtejshëm i kapaciteteve institucionale dhe njerëzore, qëllim ky që është në funksion të përputhshmërisë së auditimeve të kryera me ISSAI. Në të njëjtën kohë është raportuar për azhurnim të rregullt të udhëzuesit dhe metodologjisë së ZKA-së për auditimin e rregullsisë dhe performancës në përputhje me standardet ndërkombëtare të auditimit. Po ashtu kanë vazhduar bashkëpunimet me dy komisionet parlamentare: Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike dhe Komisioni për Buxhet për të diskutuar në lidhje me përmbledhjet e raporteve të auditimit të ZKA për Komisionet parlamentare, më konkretisht përgatitja e materialeve për trajtimet e Raporteve të auditimit.

Në këtë fazë raportimi nuk mund të bëhet në nivel të indikatorëve për shkak të natyrës së indikatorëve të përcaktuar në nivel vjetor.



Prioriteti 9. Zhvillimi i një institucioni suprem të auditimit që funksionon mirë, i cili kryen auditime në përputhje me standardet e auditimit të sektorit publik të pranura ndërkombëtarisht.

Treguesi (-ët) për matjen e arritjes së Prioritetit	Baza	Qëllimi 2018	Qëllimi 2020	Raportimi ⁸ Janar- Qershor 2018
1. Përqindja e raporteve të auditimit të shqyrtuara nga Komisioni për Mbikëqyrje të Financave Publike.	10%	0%	50%	12,5%
2. Përqindja e rekomandimeve të adresuara të lëshuara nga Zyra Kombëtare e Auditimit.	32 %	45%	0%	34%
3. Përqindja e rekomandimeve të pa adresuara të lëshuara nga Zyra Kombëtare e Auditimit.	37%	25%	20%	40%

1.4 SHTYLLA 4: ÇËSHTJET E NDËRLIDHURA TË MFP

PRIORITETI 10: PËRMIRËSIMI I SISTEMEVE TË TI

Prioriteti dhjetë (10) merret me përmirësimin e sistemeve të teknologjisë informative me qëllim të përmirësimit të menaxhimit të financave publike. Për arritjen e këtij prioriteti, janë gjithsej 3 aktivitete të planifikuara. Gjatë kësaj periudhe gjashtë mujore është raportuar progres i pjesshëm në realizimin e këtyre aktiviteteve.



Prioriteti 10. Përmirësimi i sistemeve të TI që funksionojnë në Ministrinë e Financave për ta përmirësuar cilësinë e informatave financiare.

Treguesi (-ët) për matjen e arritjes së Prioritetit	Baza	Qëllimi 2018	Qëllim i 2020	Raportimi Janar- Qershor 2018
1. Numri i sistemeve të Integruara.	0	5	7	NA

PRIORITETI 11: TRANSPARENCA PËR BUXHETIN


Prioriteti i njëmbëdhjetë (11) ka të bëjë me sigurimin e transparencës së shpenzimit të fondeve publike, që për prioritet ka sigurimin e pajtueshmërisë së informatave për Buxhetin e Kosovës me FMN, përkatësisht me standardin 2014 GFS. Janë gjithsej gjashtë (6) aktivitete të planifikuara për përmbushje të këtij prioriteti. Bartës kryesor i këtyre aktiviteteve është

⁸ Të dhënat nga Tabela 17, RAPORTI VJETOR I AUDITIMIT për 2017, http://www.zkars.org/wp-content/uploads/2018/08/RVA-2017_Shqip.pdf

Thesari, MF. Gjatë periudhës raportuese Janar- Qershor 2018, është raportuar për progres të kënaqshëm në zbatimin e 3 aktiviteteve (11.4-11.6), ndërsa në tri aktivitetet tjera 11.1- 11.3, raportohet për progres të pjesshëm, dhe që zbatimi i tyre pritet të ndodhë deri në fund të vitit. Më specifikisht, brenda kësaj periudhe Thesari në bashkëpunim me projektin e USAID, kanë draftuar Planin kontabël ekzistues sipas GFSM 2014.


Në të njëjtën kohë, Thesari ka vazhduar me publikimin e rregullt të të dhënave mujore-serive kohore për të hyrat dhe shpenzimet buxhetore për periudhën (2006-2018). Në ueb-faqen e MF është mundësuar publikimi dhe qasja në të dhëna fiskale në baza mujore, në format elektronik, duke ofruar transparencë të plotë për shfrytëzimin e parasë publike.

Ne funksion të rritjes së transparencës dhe sqarimit më të thjeshtë të Buxhetit për vitin 2018, Departamenti i Buxhetit në përkrahje të GIZ, ka publikuar për herë të parë Informatorin për qytetaret lidhur me Buxhetin e Kosovës për vitin 2018, i publikuar në ueb faqen e Ministrisë së Financave (në linkun <http://mf.rks-gov.net/page.aspx?id=1,33>). Informatori për qytetarë, ofron një përmbledhje të thjeshtë dhe lehtë të kuptueshme të strukturës së buxhetit, për publikun e gjerë.

 Prioriteti 11. Sigurimi i pajtueshmërisë së informatave për buxhetin e Kosovës me FMN/ standardin 2014 GFS				
Treguesi (-ët) për matjen e arritjes së Prioritetit	Baza	Qëllimi 2018	Qëllimi 2020	Raportimi Janar-Qershor 2018
1. Buxhetimi dhe raportimi sipas tabelës së llogaritjeve që është në pajtim me GFS 2014	Ka filluar Publikimi	Planifikimi Buxhetor sipas GFS 2014	Standardi GFS 2014 në përdorim	NA

PRIORITETI 12: NGRITJA E QËNDRUESHME E KAPACITETEVE NË MFP

Gjatë periudhës kohore, janë hartuar termat e referencës (ToR) për Studimin e Fizibilitetit. Në bashkëpunim me ZBE janë bërë përgatitjet për takimin e donatorëve relevant në fushën e MFP, për të parë mundësinë e përkrahjes me Asistencë teknike në zhvillimin e Studimit të Fizibilitetit. Nuk është arrit sigurimi i mjeteve. Mbetet që me rishikim të Planit të Veprimit të analizohet mundësia e sigurimit të mjeteve nga SBS.

 Prioriteti 12. Arritja e një mënyrë sistematike, e qëndrueshme dhe e integruar e ngritjes së kapaciteteve të nëpunësve civilë në Menaxhimin e Financave Publike duke e shfrytëzuar ekspertizën vendore, të administratës publike dhe atë të jashtme.				
Treguesi (-ët) për matjen e arritjes së Prioritetit	Baza	Qëllim i 2018	Qëllim i 2020	Raportimi Janar-Qershor 2018
1. Numri i programeve për trajnimin në MFP				
2. Numri i zyrtarëve të trajnuar në fushën e MF				

ANEKS 1. SHPJEGIM I DETAJUAR MBI ZBATIMIN E SECILIT AKTIVITET

Shtylla 1 Disiplina fiskale

Prioriteti 1: Saktësia e parashikimit të indikatorëve makroekonomik dhe të hyrave;

Komente për statusin e aktiviteteve 1.1- 1.5

Në arritjen e prioritetit 'Saktësia e parashikimit të indikatorëve makroekonomik dhe të hyrave', janë paraparë 5 aktivitete që ndërlidhen me përfundimin e disiplinës fiskale si një parakusht, në mirëmbajtjen e qëndrueshmërisë fiskale. Aktivitetet përfshijnë fazat duke filluar nga trajnimi i stafit përgjegjës në parashikime dhe deri te publikimi i dokumenteve relevante të cilat përcaktojnë përgjegjësinë institucionale kundrejt publikut dhe partnerëve tjerë ndërkombëtar.

Gjatë periudhës raportuese Janar- Qershor 2018, nga pesë aktivitete të planifikuara për arritjen e këtij prioriteti, në katër prej tyre (1.2- 1.5) nuk është raportuar për progres gjatë kësaj periudhe, ndërsa lidhur me aktivitetin (1.1) që ndërlidhet me trajnimin e stafit të njësisë së makroekonomisë është shënuar progres.

(1.1) Të siguruarit e kapacitetit të mjaftueshëm të stafit të trajnuar të njësisë makroekonomike. Gjatë periudhës Janar-Qershor 2018, kanë vazhduar trajnimet për stafin, si nevojë për trajnime përkatëse në fushën e makroekonomisë, në veçanti modelimin e indikatorëve makroekonomik dhe projeksionin e të hyrave fiskale. Edhe gjatë periudhës Janar-Qershor 2018, kanë vijuar trajnimet adekuate të stafit nga USAID, Banka Botërore si dhe nga projekti i Lux Development.

(1.2) Publikimi i metodologjisë së hartimit të parashikimeve ekonomike. Gjatë kësaj periudhe raportuese nuk është ndërmarrë ndonjë aktivitet në lidhje me publikimin e metodologjisë së hartimit të parashikimeve makroekonomike.

(1.3) Publikimi i kornizës makro-fiskale dhe indikatorëve ekonomikë para miratimit të KASH dhe Ligjit Vjetor të Buxhetit. Edhe gjatë vitit 2018 korniza makro-fiskale dhe indikatorët ekonomik janë publikuar si pjesë të Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve 2019-2021, dhe jo siç është paraparë para publikimit të KASH 2019-2021.

(1.4) Vendosja e pavarësisë së njësisë makroekonomike. Nuk është ndërmarrë ndonjë aktivitet gjatë periudhës raportuese.

(1.5) Nxjerrja e një rregulloreje që do ta kufizonte përfshirjen e të hyrave që ndodhin vetëm një herë. Meqenëse pjesa më e madhe e të hyrave të njëhershme kanë ardhur nga Ligji për faljen e borxheve, si dhe duke pas parasysh që ligji ishte në fuqi deri më 31 gusht 2017, ky grup nuk do të krijohet.

Prioriteti 2: Kontrollat efektive të zotimeve

Komenti për statusin e arritjeve në aktivitetet 2.1-2.10

Për arritjen e këtij qëllimi, strategjia ka grupuar 10 aktivitete. Marrë parasysh kohën e shkurtër për të cilën po raportohet, në krahasim me pikat referuese për vitin 2018 është evidentuar progres në zbatim tek një numër i konsiderueshëm i aktiviteteve edhe pse janë aktivitete në proces përgjatë tërë vitit siç janë aktivitetet : 2.1; 2.2; 2.4; 2.6; 2.7; 2.8; 2.9 dhe 2.10. Ndërsa në dy prej aktiviteteve është raportuar për vonesa në zbatim 2.3 dhe 2.5. Të dy këto dy aktivitete janë të ndërlidhura me vonesën e hartimit të UA-ve përkatëse.

(2.1) Ndryshimet në LMFPF/Rregullore.- Veprimi ka të bëjë me ndryshimet ligjore në KBFP. Ligji i KBFP është dekretuar nga Presidenti i Kosovës dhe ka hyrë në fuqi prej muajit Maj 2018.

(2.2) Trajnimi dhe ndërtimi i kapaciteteve të zyrtarit (-ëve) financiar.- Në bashkëpunim me USAID-në është organizuar punëtorja për përgatitjen e "Planit të veprimit për implementimin e rekomandimeve të Auditorit të përgjithshëm dhe të brendshëm ". Në këtë punëtori kanë marrë pjesë 70 pjesëmarrës si dhe po zhvillohet një trajnim për ngritjen e transparencës nëpër komuna pilote.

(2.3) Futja në përdorim e kontabilitetit të KESH të modifikuar dhe raportimit - raportohet për vonesë në zbatim të këtij aktiviteti. Ende nuk është hartuar UA që krijon bazën ligjore për futjen në përdorim të kontabilitetit të KESH-it të modifikuar.

(2.4) Identifikimi dhe krijimi i kontroleve.- Në bashkëpunim me USAID-në është organizuar punëtorja për përgatitjen e përshkrimit të proceseve. Gjatë kësaj periudhe është hartuar dokumenti standard për përshkrimin e proceseve mbi funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm të financave publike në sektorin publik i cili është aprovuar nga Ministri i MF-së dhe iu është dorëzuar OB-ve në Janar të vitit 2018.

(2.5) Zgjerimi i funksioneve të SIMFK- Krahasuar me pikën e referimit për vitin 2018, kemi vonesë në zbatim të këtij aktiviteti. Ende nuk është kryer UA për planin e ri kontabël.

(2.6) Rishikimi i rregullores financiare për raportimin e vonesave në pagesa- Nga muaji Mars 2018, THESARI është duke monitoruar OB-te për vonesat në regjistrim të transaksioneve në SIMFK (Certifikim të pagesave) dhe monitorimin e dokumentacionit financiar që lidhen me transaksionet e regjistruara në SIMFK.

(2.7) Raportimi i borxheve të brendshme nga Njësia e borxheve- Njësia e Monitorimit në Thesar monitoron dhe grumbullon të dhëna tremujore për borxhet e OB-ve

(2.8) Sanksionimi i organizatave buxhetore në rastet e vonesës në pagesa- Gjatë monitorimeve në vitin 2018 ka pasur raste kur OB-të janë njoftuar me e-mail lidhur me vonesat e shkaktuar në kundërshtime me aktet primare dhe sekondare të financave publike. Gjatë vitit 2018 do të analizohen të gjitha OB-të që kanë shkaktuar gabime sistematike dhe do të ndërmerren masa sipas kërkesave të LMFPF-se.

(2.9) Monitorimi e OB-ve nëpërmes SIMFK-së dhe arkivës elektronike.- Nga muaji Mars 2018 Thesari është duke monitoruar OB-te për vonesat në regjistrim të transaksioneve në SIMFK (Certifikim të pagesave) dhe monitorimin e dokumentacionit financiar që lidhen me transaksionet e regjistruara në SIMFK.

(2.10) Ngritja e kapaciteteve tek Njësia për Monitorimit (NJpM)- Gjatë kësaj periudhe raportuese, Thesari ka vazhduar me trajnime të avancuara të stafit.

Prioriteti 3: Mbledhja e qëndrueshme e të hyrave

Komenti për statusin e arritjeve në aktivitetet 3.1-3.12

Për arritjen e këtij qëllimi, strategjia ka grupuar 12 aktivitete. Lidhur me realizimin e këtij prioriteti, në krahasim me pikat referuese për vitin 2018 është evidentuar progres në zbatim tek një numër i konsiderueshëm i aktiviteteve edhe pse janë aktivitete në proces përgjatë tërë vitit siç janë aktivitetet : 3.1; 3.2; 3.3; 3.5; 3.6; 3.7; 3.8; 3.9; 3.10 dhe 3.11). Ndërsa që në njërën prej aktiviteteve gjegjësisht aktivitetin 3.4 është raportuar për vonesa në zbatim.

(3.1) Themelimi i Agjencisë së Tatimeve dhe Doganave të Kosovës (ATDK)- Me qëllim të zhvillimit të institucionit në harmoni me parimet ndërkombëtare, ATK gjatë periudhës raportuese ka arritur progresin si në vijim:

- Ka realizuar aktivitete të rëndësishme në ndërtimin e funksionit të shërbimit ndaj tatimpaguesve;
- shfrytëzimi i deklaramit elektronike është rritur sa tani është në nivel 100%;
- është zhvilluar procesi i menaxhimit të kërkesave të rimbursimit, që nënkupton se tatimpaguesit paraqesin kërkesën për rimbursim Online;
- Organizimi institucional ka pasur reformim, zhvillim pozitiv, pasi që ATK është organizuar rreth aktiviteteve funksionale;

- është aprovuar Plani Afat Mesëm i Reformës 2019-2021.

(3.2) Futja e shërbimit elektronik të e-faturës- gjatë periudhës raportuese nuk ka pasur zhvillim, pasi që fatura elektronike është pjesë e specifikave që janë hartuar për Sistemin e Modernizimit të TI. Prandaj, ky aktivitet do të realizohet në kohën kur fillon faza e parë e zbatimit të sistemit të ri. Sa i përket hapave të ardhshëm, mbetet të pritët deri në fillimin e sistemit të ri të TI, i cili pritët të funksionalizohet deri me 2021/2022.

(3.3) Modernizimi i sistemit të teknologjisë informative- gjatë periudhës raportuese është përfunduar procesi i tenderimi të modernizimit të sistemit informativ, ku kanë aplikuar gjithsej 6 operatorë ekonomik në formë të konzorciumit. Lidhur me këtë, legjislacioni i prokurimit publik, ka paraparë edhe fazën e kërkesës për sqarime shtesë nga ATK për operatorët ekonomik. Aktualisht, procesi është në fazën e shqyrtimit të 1 ankese nga operatorët ekonomik e cila është dorëzuar në Organin Shqyrtues të Prokurimit.

(3.4) Rritja e shkathtësive dhe aftësive të stafit / Ndërtimi i kapaciteteve të Sektorit për Menaxhimin e Rrezikut. Gjatë periudhës raportuese nuk është realizuar ndonjë trajnim në fushën e menaxhimit të rrezikut të përmbushjes.

(3.5-3.6) Trajnim i avancuar dhe zhvillim i kapacitetit për zyrtarët doganorë në fushat e vlerësimit, Origjinës dhe Vlerësimit të mallit: Përgjatë gjashtëmujorit të parë të 2018 janë mbajtur 5 aktivitete trajnuese, me 60 zyrtarë të trajnuar nga fushat respektive

(3.7) Rifreskimi rregullt i profileve të riskut, për të adresuar rreziqet e mallrave të nënvlerësuar. Gjatë periudhës Janar-Qershor 2018, në sistemin e selektivitetit në ASYCUDA janë aktivizuar 61 kritere të riskut, 224 janë modifikuar dhe 43 janë deaktivizuar, ndërsa në lista të selektivitetit janë azhurnuar 2662 subjekte.

(3.8) Aplikimi i patrullave në vijën kufitare me fokus në vendet e njohura me risk të lartë. Dogana e Kosovës në vazhdimësi aplikon patrullime në vendet e njohura me risk të lartë. Këto patrullime zhvillohen kryesisht nga ekipet e antikontrabandës dhe gjatë periudhës raportuese janë zhvilluar 466 patrullime përreth vijës së gjelbër. Gjithashtu me qëllim të identifikimit të mallrave, mjeteve dhe personave të cilët janë të përfshirë në kontrabandim, Dogana e Kosovës i shfrytëzon edhe kamerat mobile të cilat i vendos në varësi të riskut të identifikuar. Me përdorimin e këtyre kamerave janë shënuar edhe rezultate konkrete në identifikimin e automjeteve që përdoren për kontrabandim si dhe ndalimin dhe konfiskimin e mallrave të kontrabanduara.

(3.9) Aktivizimi i sistemit të kamerave (Donacion nga EXBIS) të kontrollit të kufirit në vijën e gjelbër. Kamerat mobile janë aktive dhe po përdoren nëpër lokacione të caktuara përgjatë vijës së gjelbër dhe shërbejnë për të dërguar imazhe të automjeteve dhe personave që tentojnë të kontrabandojnë mallra të ndryshme, në veçanti cigare. Me përdorimin e këtyre kamerave janë shënuar edhe rezultate konkrete në identifikimin e automjeteve që përdoren për kontrabandim si dhe ndalimin dhe konfiskimin e mallrave të kontrabanduara

(3.10) Aplikimi i kontrolleve të përbashkëta me Policinë Kufitare. Bashkëpunimi dhe bashkërendimi i aktiviteteve kufitare me Policinë e Kosovës gjatë gjashtëmujorit të parë është zhvilluar ashtu siç është planifikuar. Janë zhvilluar patrullime dhe takime të rregullta. Janë organizuar takime të përbashkëta dhe patrullime për ngritje të nivelit të bashkëpunimit dhe bashkërendimit të aktiviteteve, ku si rrjedhojë janë kryer edhe patrullime të përbashkëta në drejtoritë rajonale me Policinë Kufitare.

(3.11) Rritja e informatave nga sektori i Inteligjencës për drejtoritë rajonale. Gjatë periudhës janar-qershor 2017. Sektori i Inteligjencës në sektorët dhe drejtoritë rajonale në Doganë ka shpërndarë 1158 informacione të përpunuara me drejtoritë rajonale dhe sektorë të tjerë brenda doganës.

(3.12) Aplikimi i duhur i metodave të vlerësimit të mallit. Dogana e Kosovës për vlerësimin e mallrave i përdorë gjashtë metodat e Organizatës Botërore të Tregtisë. Gjatë gjashtëmujorit të parë 2018, janë përdorur të gjashtë metodat e vlerësimit. Metodatat e vlerësimit për periudhën raportuese janë përdorur si vijon: Metoda e vlerësimit 1: 96.85%, metoda e vlerësimit 2: 0%,

metoda e vlerësimit 3: 0.01%, metoda e vlerësimit 4: 0%, metoda e vlerësimit 5: 0%, dhe metoda e vlerësimit 6: 3.13%.

Shtylla 2: Efikasiteti alokues

Prioriteti 4: Zhvillimi i kornizës afatmesme të shpenzimeve (KASH)

Komente për statusin e arritjeve ne aktivitetet 4.1-4.5

Për arritjen e këtij prioriteti janë planifikuar pese (5) aktivitete dhe në krahasim me pikat referuese për vitin 2018, është evidentuar progres në zbatimin e katër aktiviteteve 4.1; 4.2; 4.4 dhe 4.5, ndërsa aktiviteti 4.3 është në proces dhe pritet finalizimi i tij, i ndërlidhur me K4 të vitit 2018. Prandaj për progresin e tërësishëm të këtij prioriteti do të raportohet në raportin vjetor.

(4.1) Funksionalizimi i Grupit Drejtues për Planifikim Strategjik (GDPS), dhe i Komisionit për Planifikim Strategjik. Sa i përket këtij aktiviteti Grupi Drejtues për Planifikim Strategjik (GDPS) dhe i Komisionit për Planifikim Strategjik kanë shqyrtuar Deklaratën e Prioriteteve dhe po ashtu Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve (2019-2021), ndërsa sa i përket aktivitetit të 3 qe ka të bëjë me shqyrtimin e Draft Buxhetit vjetor pritet të realizohet në Tetor 2018, kur edhe bëhet dorëzimi i buxhetit për vitin 2019 nga MF në Qeveri.

(4.2) Trajnimi për fuqizimin e vlerësimit të ndikimit buxhetor. Për këtë aktivitet MF ka ofruar këshillime profesionale të duhura dhe të nevojshme për zyrtarë të OB-ve të nivelit qendror, dhe për këtë periudhë të raportimit ky aktivitet është në vazhdimësi (50 zyrtarë të OB të këshilluar, sugjeruar, sqarime në lidhje me plotësimin e formularëve për VNB).

(4.3) Përgatitja e njoftimeve sqaruese për shmangie ndërmjet kufirit të KASH dhe kufirit të buxhetit vjetor. Ndërsa sa i përket aktivitetit për përfshirjen e Tabelës së standardizuar për paraqitjen e shmangieve në kufijtë e KASH dhe ndarjes buxhetore finale, ky aktivitet është në proces dhe pritet që me rastin e dorëzimit të Projekt Ligjit të Buxhetit në Kuvend për vitin 2019 të i bashkëngjiten edhe këto tabela.

(4.4) Vlerësimi i rrezikut nga organizatat buxhetore për planifikim të buxhetit. Me qëllim të realizimit të këtij aktiviteti, për vitin 2018 planifikohet të trajnohen 130 zyrtarë në tërë Qeverinë mbi vlerësimin e riskut. Me planin e trajnimeve, ky trajnim është planifikuar të mbahet në periudhën K4.

(4.5) Zbatimi i qasjes sektoriale gjatë përgatitjes së KASH. Aktiviteti i kryer, KASH 2019-2021 është punuar në baza sektoriale.

Prioriteti 5: Besueshmëria dhe kontrolli i ekzekutimit të buxhetit vjetor

Komente për statusin e arritjeve ne aktivitetet 5.1-5.3

Për arritjen e këtij prioriteti janë planifikuar tre (3) aktivitete dhe ne këtë periudhë të raportimit gjashtëmujor janë zhvilluar këto aktivitete:

(5.1) Përgatitja e udhëzimit administrativ për transferimet - ri-alokimet – Ky aktivitet është në zbatim e sipër të hartimit si pjesë e pakos së tri UA, (UA për transfere dhe ri-alokime, UA për definimin e investimeve kapitale). Është formuar grupi punues brenda MF-se, ende është në proces të draftimit të tij, pritet që deri në fund të vitit të aprovohet.

(5.2) Buxhetimi i bazuar në programe. Ky aktivitet është paraparë pas vitit 2018, nuk ka ndonjë veprim konkret, me rishikimin e PV të strategjisë 2018-2020 do të shikohen hapat që do të ndërmerren për këtë aktivitetet. Aktualisht, është duke u punuar që me Buxhetin e 2019, të publikohen si aneks edhe indikatorët e performancës të përgatitur nga OB.

(5.3) Hartimi i një plani strategjik për buxhetimin Programor. Ky aktivitet është paraparë pas vitit 2018, nuk ka ndonjë veprim konkret, me rishikimin e PV të strategjisë 2018-2020 do të shikohen hapat që do të ndërmerren për këtë aktivitetet.

Prioriteti 6: Cilësia e informatave të buxhetit kapital

Komenti për statusin e arritjeve në aktivitetet 6.1.-6.4

Për arritjen e këtij Prioriteti janë planifikuar katër (4) aktivitete dhe në krahasim me pikat referuese për vitin 2018, është evidentuar progres në zbatimin e dy aktiviteteve; 6.2 dhe 6.4 ndërsa aktivitetet 6.1 dhe 6.3 janë në proces dhe pritet finalizimi i tyre deri në fund të vitit 2018. Prandaj për progresin e tërësishëm të tyre do të raportohet në raportin vjetor.

(6.1) Miratimi i një Rregulloreje/Instruksioni nga Qeveria për ta fuqizuar Departamentin e Buxhetit që ofron një kornizë të qartë për politik-bërësit dhe përdoruesit e PIP-it në lidhje me metodologjinë e vlerësimit dhe përzgjedhjen e projekteve- Deri më tani, është raportuar se është formuar grupi punues brenda MF-së që do të hartoj këtë Rregullore. Deri në fund të vitit pritet që të hartohet kjo rregullore dhe të përcillet tutje për aprovim.

(6.2) Organizimi i trajnimit për sistemin PIP (trajnimi i zyrtarëve të rinj si dhe rifreskimi i njohurive të zyrtarëve ekzistues) - Gjatë periudhës raportuese, janë trajnuar gjithsej 102 zyrtarë për sistemin e PIP-it, në nivelin qendror dhe lokal.

(6.3) Nxjerrja e një udhëzimi që e definon qartë se çka duhet të trajtohet projekt kapital Deri më tani, është raportuar se është formuar grupi punues brenda MF-së që do të hartoj këtë Rregullore. Deri në fund të vitit pritet që të hartohet kjo rregullore dhe të përcillet tutje për aprovim.

6.4. Punësimi i 3 Zyrtarëve të TI për mirëmbajtje dhe zhvillim të sistemit. Aktiviteti i përfunduar në vitin 2016.

Shtylla 3: Efikasiteti operacional

Prioriteti 7: Prokurimi Publik

Komente për statusin e arritjeve në aktivitetet 7.1-7.5

Për arritjen e këtij prioriteti janë planifikuar pesë (5) aktivitete dhe në krahasim me pikat referuese për vitin 2018 është evidentuar progres në zbatimin e të katër aktiviteteve (7.1-7.4), ndërsa sipas planit, aktiviteti 7.5 pritet të realizohet në gjysmën e dytë të vitit 2018.

(7.1) Themelimi i sistemit të e-prokurimit për kryerjen e aktiviteteve të prokurimit. Nga 1 Janari i vitit 2017, ka filluar të zbatohet e-prokurimi si në nivel qendror edhe në nivelin lokal dhe/ose në të gjitha autoritetet tjera kontraktuese për vlera të mesme dhe të mëdha. Ndërsa nga Janari i vitit 2018, ka filluar të zbatohet e-prokurimi për vlera të vogla dhe për të gjitha procedurat.

Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik (KRPP) për të gjithë përdoruesit ka nxjerrë udhëzues dhe manuale të cilët janë në dispozicion në ueb-faqen e KRPP-së, si dhe në platformën e prokurimit elektronik (<http://e-prokurimi.rks-gov.net>). Po ashtu, me qëllim të mbështetjes së akterëve në e-prokurim, KRPP do të ofroj ndihmën e vazhdueshme për të gjithë përdoruesit e platformës elektronike përmes tavolinës ndihmëse.

(7.2) Zhvillimi dhe zbatimi i aktiviteteve të centralizuara të prokurimit.- Gjatë periudhës raportuese AQP, ka finalizuar gjithsej 15 kontrata të centralizuara (niveli qendror dhe lokal). Nga këto, 12 kontrata janë iniciuar në vitin 2017 dhe kanë përfunduar në vitin 2018, ndërsa 3 aktivitete të prokurimeve të centralizuara janë iniciuar dhe përfunduar në vitin 2018. Ndërsa deri tani janë iniciuar edhe 7 aktivitete të prokurimeve të centralizuara.

(7.3) Monitorimi i aktiviteteve të prokurimit publik - Departamenti për monitorim dhe mbikëqyrje i KRPP-së, gjatë periudhës së parë gjashtë mujore të vitit 2018, ka realizuar monitorimin e dyzet e shtatë (47) aktiviteteve të prokurimit, sipas rastit – kërkesës, së AK-së, Operatorëve Ekonomik apo palëve të interesuara. Gjithashtu ka bërë monitorimin e rreth 80% të njoftimeve për publikim në ueb faqen e KRPP-së.

(7.4) Vetëdijesimi i publikut të gjerë lidhur me rregullat e prokurimit publik- KRPP në bashkëpunim me IKAP dhe USAID-TEAM, ka mbajtur trajnime bazike për prokurim publik dhe për përdorimin e sistemit të e-prokurimit për Zyrtaret në nivel qendror, lokal dhe ndërmarrjet publike, përfshirë Operatorët Ekonomik, Auditorët e brendshëm të institucioneve publike lokale dhe qendrore, Drejtorët e drejtorive komunale, Anëtarët e Komisionit për hapjen e ofertave dhe vlerësim të tenderëve ku gjithsej numri i pjesëmarrësve ka qenë rreth 780.

(7.5) Trajnimi i zyrtarëve të prokurimit- Në bazë të nenit 25 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, Divizioni i trajnimeve, gjatë kësaj periudhe të këtij viti ende nuk ka organizuar ndonjë Program të trajnimit për nivel të avancuar për zyrtarët e prokurimit, kjo pritet të bëhet në pjesën tjetër të vitit.

Prioriteti 8. Fuqizimi i Auditimit të Brendshëm

Komentet për statusin e aktiviteteve 8.1 – 8.5

Për arritjen e prioritetit “Fuqizimi i auditimit të brendshëm” janë planifikuar 5 aktivitete që ndërlidhen me fuqizimin e auditimit të brendshëm si parakusht për shtimin e vlerës ndaj menaxhimit llogaridhënës. Në krahasim me pikat referuese për vitin 2018, është evidentuar progres në zbatimin e katër aktiviteteve (8.1;8.2;8.3;8.4), ndërsa në mungesë të mjeteve buxhetore është raportuar për vonesë në zbatim të aktivitetit 8.4.

(8.1) Rishikimi i Ligjit për funksionimin e Auditimit të brendshëm- Në bashkëpunim me USAID është organizuar punëtori për përgatitjen e planit të veprimit për implementimin e rekomandimeve të Auditorit të Përgjithshëm dhe të brendshëm, ku kanë marrë pjesë 70 pjesëmarrës.

(8.2) Freskimi i manualit të Auditimit të Brendshëm. Doracaku për auditimin e prokurimeve publike ka përfunduar dhe lidhur me përdorimin e tij janë trajnuar 150 AB.

(8.3) Ngritja e programit vendor për Certifikimin e Auditorëve të Brendshëm dhe trajnimi sipas nevojës - Gjatë periudhës raportuese është organizuar trajnimi për certifikimin e auditorëve të brendshëm në programin për certifikim për grupin e dytë. Gjatë kësaj periudhe raportuese janë certifikuar 16 auditorë të brendshëm në Programin për Certifikim.

(8.4) Trajnimi i auditorëve të brendshëm në auditimin e fondeve të BE. Për shkak të mungesës buxhetore nuk është ndërmarrë ende ndonjë aktivitet. Nëse krahasohet me pikën e referimit për vitin 2018, ky aktivitet shënon vonesa në zbatim. Për realizimin e këtij aktiviteti Nga Qeveria e Luksemburgut është kërkuar që përmes projektit "Projekti i Luxembourg Development (LuxDev) “Mbështetje zbatimit të PKZMSA” për ngritjen e kapaciteteve të përkrahët ky aktivitet.

(8.5) Monitorimi i implementimit të rekomandimeve të auditimit të brendshëm. Raporti vjetor për funksionimin e sistemit të KBFP-së (MFK +AB), i aprovuar nga Ministri më 26 Qershor 2018 është diskutuar në Kuvendin e Kosovës / KMFP. Miratimi i këtij raporti në kohë nga ana e Kuvendit të Kosovës është në harmoni me pikën e referimit për vitin 2018.

Prioriteti 9: Fuqizimi i auditimit të jashtëm

Komenti për statusin e arritjeve në aktivitetet 9.1-9.4

Për arritjen e prioritetit "Fuqizimi i auditimit të jashtëm" janë planifikuar katër (4) aktivitete që ndërlidhen me fuqizimin e auditimit të jashtëm si parakusht për shtimin e vlerës ndaj menaxhimit llogaridhënës. Në krahasim me pikat referuese për vitin 2018 është evidentuar progres në zbatimin e të gjithave aktiviteteve.

(9.1) Sigurimi i pavarësisë institucionale. Me hyrjen në fuqi të Ligjit të ri nr. 05/L-055 "Për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës", të dekretuar më 03/06/2016, është rregulluar qartë pavarësia funksionale, operative dhe financiare, mandati i Auditorit të Përgjithshëm si dhe organizimi i ZKA.

(9.2) Trajtimi i zbrazëtirës ndërmjet praktikës së auditimit të ZKA-së dhe të ISSAI-ve (SNISA). Është hartuar Drafti "Plani Strategjik i Zyrës Kombëtare të Auditimit" 2018-2021. Për këtë Draft Strategji janë mbajtur takime dhe është prezantuar para deputetëve (komisioneve parlamentare); organizatave donatore; OJQ dhe stafit të ZKA-së me qëllim të marrjes së sugjerimeve shitesë. Strategjia e re e ZKA-së, "Plani Strategjik i Zyrës Kombëtare të Auditimit" 2018-2021, njërin nga tre qëllimet kryesore strategjike gjatë tre viteve të ardhshme do ta ketë zhvillimin e mëtejshëm të kapaciteteve institucionale e njerëzore të ZKA-së. Strategjia e re pritet të miratohet nga Auditori i Përgjithshëm më së voni deri më 31 gusht 2018.

Ndërsa në lidhje me zhvillimin e procedurave për kryerje të auditimit përmes mjetit të kompjuterizuar të auditimit (CAAT), aktualisht ZKA është duke hartuar specifikacionet teknike për një softuer të auditimit. Për të siguruar blerjen e një softueri të auditimit, pritet që një kërkesë t'i prezantohet edhe komitetit të donatorëve për përkrahje financiare. Për momentin, ZKA përdor një softuer për analizim të të dhënave "Nxjerrja dhe Analizimi Interaktiv i të dhënave - IDEA - Interactive Data Extraction and Analysis). Ky softuer përdoret për qëllime mostrimi dhe rishikime analitike.

(9.3) Përditësimi i Udhëzuesit për Auditimin e Rregullsisë. Udhëzuesi i ri i auditimit të rregullsisë në pajtim me ISSAI-të - Udhëzuesi dhe metodologjia e ZKA-së për auditimin e rregullsisë azhurnohen në vazhdimësi për të qenë në përputhje me standardet ndërkombëtare të auditimit. Ngritja e kapaciteteve dhe zhvillimi profesional i stafit të auditimit është një nga objektivat strategjike të ZKA. Gjatë vitit, janë organizuar trajnime brenda vendit nga trajner të brendshëm dhe ndërkombëtar. Janë organizuar seanca trajnimesh me tema të ndryshme, kryesisht nga fusha e auditimit. Në total, 115 punonjës kanë përfituar nga këto trajnime. Përveç këtyre janë organizuar edhe punëtori, seminare dhe konferenca të ndryshme me qëllim të përmirësimit të proceseve të brendshme të punës. Po ashtu, pas nënshkrimit të marrëveshjes afatgjatë ndërmjet ZKA-së dhe Zyrës Kombëtare të Auditimit të Suedisë, për bashkëpunim bilateral, janë mbajtur një numër i punëtorive në fushën e lidërsipit dhe menaxhimit për nivelin drejtues të ZKA. Sesioni i ardhshëm i trajnimeve do të mbahet në Gusht të vitit 2018, nga vetë ZKA, kurse ato të planifikuara me SNAO do të mbahen në Shtator 2018.

(9.4) Zhvillimi i mëtejshëm i praktikës së auditimit të performancës. Udhëzuesi dhe metodologjia e ZKA për auditime të performancës azhurnohet në vazhdimësi për të qenë në përputhje me standardet ndërkombëtare të auditimit. Gjatë vitit ka pasur programe të trajnimit për auditor të performancës nga ekspertët e SNAO, të cilët kanë ofruar edhe mentorim të auditimeve të caktuara. Për këtë aktivitet, në periudhën e ardhshme, në lidhje me trajnimin dhe certifikimin e auditorëve të Performancës, pritet të dizajnohet dhe implementohet skema e certifikimit me përkrahjen e Zyrës Kombëtare të Auditimit të Suedisë dhe partnerëve tjerë.

(9.5) Përfshirja e Kuvendit- Në funksion të rritjes së komunikimit dhe përfshirjes së Kuvendit, në shqyrtimin më të madh të raporteve të auditimit në Kuvend dhe rritjen e shkallës së rekomandimeve të adresuara përkatësisht zvogëlimin e shkallës së rekomandimeve të pa

adresuara, më 27-28 Qershor 2018 janë mbajtur punëtori me dy komisionet parlamentare; **Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike dhe Komisioni për Buxhet**. Megjithatë ashtu siç është raportuar në tabelën e Indikatorëve, përqindja e raporteve të auditimit të shqyrtuara nga KMFP është shumë më e ulët krahasuar me synimin për vitin 2018. Ngjashëm vlen edhe për përqindjen e rekomandimeve të adresuara të lëshuara nga ZKA Ndërsa që Konferenca e ardhshme e ZKA është planifikuar të mbahet më 4-5 Tetor 2018.

Shtylla 4: Çështjet e ndërlidhura të MFP

Prioriteti 10: Përmirësimi i sistemeve të TI

Komenti për statusin e arritjeve në aktivitetet 10.1-10.3

Për arritjen e prioritetit "Përmirësimi i sistemeve të TI" janë planifikuar tre (3) aktivitete që ndërlidhen me avancimin e sistemeve të IT si faktor i rëndësishëm në përmirësimin e raportimit dhe menaxhimit të duhur të financave publike. Në krahasim me pikat referuese për vitin 2018 është evidentuar progres i pjesshëm në zbatimin e të gjithave aktiviteteve.

(10.1) Integrimi i sistemeve të TI në MF dhe agjencitë e saja vartëse- Gjatë periudhës raportuese Janar- Qershor 2018, është raportuar që, ka përfunduar analiza e nevojave për integrim të sistemeve si dhe dizajnimi i zgjidhjes.

(10.2) Modernizimi i SIMFK, ngritja e kapaciteteve të teknologjisë informative të Thesarit-

(10.3) Krijimi i një arkivi elektronik për Organizatat Buxhetore- Gjatë periudhës raportuese Janar- Qershor 2018, është raportuar se ka filluar pilotimi tek disa OB për krijimin e arkivës elektronike duke bashkëngjitur dokumentacionin financiar si Kontratën dhe Faturën në SIMFK.

Prioriteti 11: Transparenca për buxhetin

Komenti për statusin e arritjeve në aktivitetet 11.1-11.6

Për arritjen e prioritetit në lidhje me "Sigurimin e pajtueshmërisë së informatave për Buxhetin e Kosovës me FMN/standardin GFS2014" janë planifikuar 6 aktivitete që ndërlidhen me rritjen e transparencës buxhetore si parakusht për shtimin e vlerës ndaj menaxhimit llogaridhënës. Në krahasim me pikat referuese për vitin 2018, është shënuar progres i kënaqshëm në zbatimin e 3 aktiviteteve (11.4-11.6), ndërsa në tri aktivitetet tjerë 11.1-11.3, raportohet për progres të pjesshëm, ku zbatimi i tyre pritet të ndodhë deri në fund të vitit.

(11.1) Modifikimi i SIMFK për ta mundësuar përgatitjen e automatizuar të raporteve të buxhetit në pajtim me GFS- Është në proces përgatitja e dokumentit ku specifikon të gjitha kategoritë ekonomike në planin kontabël dhe jep detaje të mjaftueshme në formë përshkrimi se çka regjistrohet në secilin kod të planit kontabël.

(11.2) Rishikimi i planit kontabël të Qeverisë - Gjatë periudhës gjashtë mujore 2018 është draftuar plani kontabël ekzistues sipas GFSM 2014 në bashkëpunim me USAID. Gjatë pjesës së mbetur të vitit do të finalizohet Plani ekonomik kontabël sipas GFS 2014 duke inkorporuar edhe inputet e Organizatave Buxhetore.

(11.3) Miratimi i një strukture të re kontabël të harmonizuar me IPSAS dhe GFS dhe të inkorporohet në SIMFK. Gjenerimi i raporteve në mënyrë automatike nga SIMFK pritet të ndodhë pas draftimit të planit kontabël sipas GFSM 2014. Pas rishikimit të UA për planin kontabël do të krijohen vegla që në mënyrë automatike do gjenerohen raportet sipas GFSM 2014.

(11.4) Përkthimi i Manualit për statistikat financiare qeveritare dhe trajnimi i zyrtareve për strukturën e re kontabël. Njësia për Monitorim në vazhdimësi ka monitoruar shpenzimet e

krijuara nga OB sipas planit kontabël, njëherit ka dhënë rekomandime disa prej OB -ve lidhur me angazhimin e kodeve gjegjëse për shpenzimet e krijuara.

(11.5) Publikimi i serive kohore të të hyrave dhe shpenzimeve të qeverisë së përgjithshme
Publikimi i të dhënave mujore - seritë kohore për të hyrat dhe shpenzimet buxhetore për periudhën (2006-2018). Në ueb-faqen e MF është mundësuar publikimi dhe qasja në të dhëna fiskale në baza mujore, në format elektronik, duke ofruar transparencë të plotë për shfrytëzimin e parasë publike. Thesari në baza mujore ofron (azhurnon ueb - faqen e MF) për publikim të dhëna mujore - seritë kohore për të hyrat dhe shpenzimet buxhetore. Po ashtu kemi bashkëpunuar me njësinë Makro në MF, lidhur me te hyrat vetanake të krijuar nga Niveli Qendror dhe Niveli Lokal gjatë periudhës paraprahe (2015, 2016, 2017, 2018).

(11.6) Hartimi i Dokumentit të Buxhetit Miqësor (Narrativ).- Informatori për qytetaret për Buxhetin e Kosovës për vitin 2018 është i publikuar në ueb faqen e Ministrisë së Financave (në linkun <http://mf.rks-gov.net/page.aspx?id=1,33>).

Me rastin e dërgimit të draft ligjit të buxhetit në Kuvend për vitin 2018 i është bashkëngjitur edhe korniza makrofiskale, e cila ka bërë përshkrimin e buxhetit për vitin 2018.

Prioriteti 12. Ngritja e qëndrueshme e kapaciteteve në MFP

Komenti për statusin e arritjeve në aktivitetet 12.1-12.3

Për arritjen e prioritetit në lidhje me ngritjen e qëndrueshme të kapaciteteve në MFP janë ndërmarr disa iniciativa, të cilat nuk ka rezultuar me sigurimin e mjeteve për zbatimin e studimit të Fizibilitetit, i cili do të ofronte zgjidhjen më të mirë për këtë Prioritet..

12.1 Zhvillimi i studimit të fizibilitetit mbi Qendrën e Trajnimeve për MFP, përfshirë vlerësimin e nevojave për trajnime.- Termt e Referencës për Studimin e Fizibilitetit, edhe pse të hartuara, nuk janë finalizuar me studim për shkak se nuk është arritur të sigurohen mjetet financiare. Ky aktivitet do të analizohet me rastin e rishikimit të Planit të Veprimit.

12.2 Përgatitja e Kurrikulës në Menaxhimin e Financave Publike.- pas përfundimit të Studimit të fizibilitetit.

12.3 Ofrimi i trajnimeve në fushën e MFP.- pas hartimit të Kurrikulës.